

Gjykata Komunale e Prizrenit
P. nr. 1023/10
18 Mars 2011



NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA KOMUNALE E PRIZRENIT

Gjyqtari i EULEX-it Witold Jakimko si kryetar i trupit gjykues,

I asistuar nga;

Eriona Bitri Brading, Vlora Johnston, Valentina Gashi, Sonila MacNeil si
procesmbajtësit

Ne rastin penal kunder

Te pandehurit **R.K.** i lindur më _____ në _____ komuna e
_____, i biri i _____ dhe _____ (e lindur _____), adresa e tanishme ku
jeton është ne rrugën "_____" nr. _____, shqiptar Kosovar, numri i
identifikimit _____ i martuar, baba i dy fëmijëve, kanë përfunduar arsimin,
me gjendje të mirë financiare, nuk ka dënime të mëparshme,

I akuzuar sipas

propozimkuzes se ushtruar nga ana e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren të
datës 18 Maj 2007 me veprën penale për cenimit të paprekshmërisë së banesave në
bazë të nenit 166 (1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës,

sikurse qe eshte pershkruar me poshte

Ne baze te kerkeses me shkrim nga pronari **A.T** është bere
dëbimi i tij më 4 prill 2006 nga Njësia Zbatuese e Prizren, ne rrugën " Jusuf
Gervalla" (ish" Bulevardi i Skenderbegut") nr 67 në Prizren, disa ditë më vonë,
R.K ka okupuar lokalet e **A.T** në mes të 4 Prillit dhe
15 Qershor 2006, dmth është bere ri-hyrja e paligjshme

Me të cilën ai kishte kryer veprën penale të cenimit te paprekshmërisë së banesave
në bazë të nenit 166 (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

duke mbajtur seanca gjyqsore

më 06 dhjetor 2010, 17, 18 Janar, 1 Shkurt dhe 15 Mars 2011, ku prokuroria Publike
Komunale ishte e përfaqësuar nga Prokurori Idain Smajli, të akuzuarit dhe
mbrojtësit të tij Myrvete Qollaku,

nxjerr si ne vijim:

AKTGJYKIM

1. I pandehuri **R.K** është gjetur fajtor sepse ne baze te kerkeses me shkrim nga pronari **A.T** eshte bere dëbimi i tij më 4 prill 2006 nga Njësia Zbatuese e Prizren, ne rrugen " Jusuf Gervalla" (ish" Bulevardi i Skenderbegut") nr 67 në Prizren, disa ditë më vonë, **R.K** ka okupuar lokalet e **A.T** në mes të 4 Prillit dhe 15 Qershor 2006, dmth eshte bere ri-hyrja e paligjshme, kesntu që ai kishte kryer një vepër penale te cenimit të paprekshmërisë së banesave në bazë të nenit 166 (1) të Kodit Penal të Kosovës, kjo Gjykatë e dënon ate me burgim ne afat kohor prej gjashtë (6) muaj,

2. Konform nenit 102 pargarafi 1 te Kodit te Procedures Penale te Kosoves (ne vazhdim KPPK-se) i pandehuri duhet ti paguj shpenzimet e procedures penale.

3. Konform nenit 391 paragrafi 1 nenparagrafi 5 i KPPK-se kjo gjykat e perfeshin kohen e kaluar ne paraburgim gjate periudhes nga 18 Korriku deri me 18 Gusht 2006.

4. Konform nenit 391 para 1 nenpara 6 te KPPK-se gjykata vendos se aktgjykimi i plotefuqishem mund te shpallet ne shtyp, radio apo television

ARSYETIM

I. Histori procedurale

1. Procedurat ne lenden P. nr. 783/06

Me 5 Korrik 2006 prokurori publik ka ushtruar aktakuzen PP. 1208/06 duke e akuzuar te pandehurin me dy akuza te heqjes apo demtimit te vulave zyrtare dhe shenjave ne kundershtrim me nenin 322 para 1 te KPPK-se dhe pengimin e personit zyrtar ne kryerje te detyres ne kundershtrim me nenin 316 para 1 dhe 2 te KPPK-se. Lenda eshte regjistruar ne gjykaten komunale te prizrenit me numer te references P. 783/06. Me 18 Korrik 2006 paraburgimi eshte shqiptuar kunder te pandehurit per periudh kohore prej nje (1) muaji.

Me 24 Dhjetor 2008 gjate seances degjimore duke vendosur lidhur me propozim akuzen gjykata ka nxjerrur aktgjykimin duke i refuzuar akuzat nen nenin 316 para2 dhe 322 para 1 te Kodit te perkohshem Penal te Kosoves (ne vazhdim referohet si KPPK-ja). Vendimi mbi refuzimin nuk eshte ankimuar dhe eshte bere ligjerisht i plotfuqishem.

2. Procedurat ne lenden P.950/07

Me 23 Shkurt 2007 prokurori publik nderkomebtar ka ushtruar aktakuzen te dates 31 Gusht 2006 (pa numer te references) ne gjykatën komunale te Prizrenit. Nga kjo aktakuzë i pandehuri eshte akuzuar me tre akuzat dhe ato jane si ne vijim:

- Pengimi i personit zyrtar ne kryerje te detyres, ne kundërshtim me nenin 316 para 1 dhe 2 te KPPK-se.
- Cenimi i paprekshemrise se banesave ne kundërshtim me nenin 166 para 1 te KPPK-se
- Heqja apo demtimi i vulave apo shenjave zyrtare ne kundërshtim me nenin 322 para 1 te KPPK-se.

Më 20 Mars 2007, gjykatësi i konfirmimit e ka kthyer aktakuzën e 31 Gusht 2006 duke kërkuar nga prokurori për të korrigjuar ca mangësi në Aktakuzë.

Prandaj, më 18 Maj 2007, Prokurori Publik Ndërkombëtar paraqiti aktakuzën e korrigjuar (PP. 1208/06) qe përmbajnë të njëjtat akuza. Ky rast është regjistruar nga Gjykata me numrin e referencës P. 950/07.

Më 22 maj 2008, gjykim i kryesuar nga një gjyqtar kosovar është mbajtur për akuzën në bazë të nenit 316 paragrafi 1 i KPPK-së. *v dhe N.T* morren pjesë në seancë si palët të dëmtuara. Gjyq u pezullua.

Më 3 Mars 2009 në bazë të një kërkesë të bërë nga Prokurori i EULEX-it pas seancës dëgjimore në lidhje me rastin 950/07 kundër te pandehurit *R.K* për veprën penale të cenimit te paprekshmërisë së banesave (neni 166 i KPPK) është caktuar te gjyqtaret e EULEX -it.

Vetëm akuzën e veprës penale të përmendura më lart ishte një objekt i vendimit të EULEX-it në përzgjedhje.

Në vendimin për marrjen-mbi është ngritur se okupimi i shtëpisë erdhi si rezultat i faktit të thjeshtë se palët e dëmtuara ishin Serbë dhe shtëpia e tyre ishte i lirë.

Arsyeja e dytë është se në të njëjtën kohë për të njëjtën situatë faktike ka qenë dy dosje të ndryshme të hapur - një nga Prokurorit vendor dhe një nga Prokurori ndërkombëtar. Ai është përmendur se këto dy dosje nuk ishin bashkuar dhe për këtë arsye kishte shkaktuar një gabimi gjyqësor.

Më 16 korrik 2009, Gjykata e shkallës së parë gjatë gjykimit të parë ka gjetur të pandehurin fajtor për veprën penale sipas nenit 166 (1) të KPPK-së dhe e dënoi atë me burgim për një afat kohor prej 6 muajsh.

Më 11 Gusht 2009, avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktgjyqimit të Gjykatës Komunale në Prizren, P. 950/07. Më 20 shtator, pala e dëmtuar **D. T** ka paraqitur ankesë kundër aktgjyqimit të Gjykatës Komunale. Më 16 Tetor 2009, Zyra e Prokurorit Publik të Qarkut e informoi me shkrim se ata nuk e gjejnë të arsyeshme të paraqesë një parashtrese në pajtim me nenin 409 të KPPK-së. Më 24 Gusht 2010, Gjykata e Shkallës së 2 ka lëshuar aktvendimin me të cilin e ka anuluar vendimin e instances se 1 dhe rasti ishte kthyer për rigjykim. Aktvendimi ishte lëshuar në emër të popullit dhe është vendosur sipas ankesës se palës së dëmtuar që "nuk bien në objektin e lendes në fjale". Gjatë shqyrtimit të rastit për herë të 2 më 06 Dhjetor 2010, 17, 18 Janar, 1 Shkurt dhe 15 Mars 2011 Gjykata kishte seancat në të cilat Prokuroria Publike Komunale ishte e përfaqësuar nga Idain Smajli, me pjesëmarrjen e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij Myrvete Qollaku .

II. Perberja e trupit gjykues dhe objekti i seances

1. Sipas nenit 459 § 1 dhe § 4 të KPPK, gjatë rigjyqimit Gjykata në dhënien e një vendimi të ri do të jetë i detyruar nga neni 417 të KPPK. Gjatë gjyqimit të parë në shkallë të parë aktgjyqimi i Gjykatës së shkallës së parë, në pjesën në të cilën ajo nuk u apelua nga Prokuroria Komunale, u bë përfundimtar. Nuk kishte asnjë ankesë e ZPK, ndërsa një e ngritur nga pala e dëmtuar duhet të ketë qenë refuzuar për shkak se sipas nenit 399 § 3 të KPPK pala e dëmtuar mund të kundërshtojë një vendim vetëm në lidhje me vendimin e Gjykatës lidhur me sanksionet ndëshkuese për veprat penale të kryera kundër jetës apo trupit, kundër integritetit seksual ose kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale.

2. Vepra inkriminuese dënohet vetëm me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe kështu ata do të konsiderohet nga një gjyqtar individual. Në bazë të Nenit 22 § 3 të KPPK vepra penale e dënueshme me burgim deri në tre vjet duhet të konsiderohet nga një gjyqtar individual i Gjykatës komunale.

3. Më 24 dhjetor 2008, gjatë një seance, duke vendosur në çështjen me një numër 783/06 reference Gjykata e përbërë me një gjykatës lokal ka lëshuar një vendim duke hedhur poshtë akuzat sipas nenit 316 paragrafi 2 dhe 322 paragrafi 1 të Kodit të [Përkohshëm] Penal të Kosovës (tani e tutje të referuara si KPPK). Vendimi për refuzim nuk është apeluar dhe u bë ligjërisht i plotefuqishem.

Rregulla res iudicata ka zbatimin e saj për të gjitha akuzat sipas nenit 316 § 2 dhe 322 § 1 i KPPK-së edhe pse Gjykata nuk është e lejuar për të vendosur mbi sepse vetëm akuzën e veprës penale nga neni 166 § 1 i KPPK është marrë përsipër në juridiksionin e EULEX-it në rastin në fjalë (mungesa e juridiksionit të EULEX-it).

4. Anëtar i trupit gjykues kryesore në lenden nr 950/07 para zgjedhjes për të u bartur tek EULEX-it ishte një gjykatës lokal i cili u bë më pas një gjyqtar i shkallës së 2 në trupin gjykues të përbërë nga dy gjyqtarë vendor dhe një ndërkombëtar, nr ref. KP 171/10. Çështja u ngrit nga prokurori lokal me 6 dhjetor 2010 ne konferencë paragjyqësore f.2.

5. Avokati mbrojtës paraqiti mocionin për ndërprerjen e procedurës penale për shkak se pala e dëmtuar ka braktisur ndjekjen në bazë të nenit 326 § 2 të KPPK. (Herën e parë, shihni procesverbalin e 18 Janarit 2011 f.3) Kjo kërkesë u hodh poshtë si e pabazuar, kryesisht sepse aktakuza ishte ngritur nga prokurori publik dhe për këtë çështje nuk ishte as e qartë as *de facto* nuk kishte qendrim të bërë nga pala e dëmtuar gjatë gjykimit.

6. **V.T** ka konfirmuar se kërkesa e saj pronësore ishte realizuar dhe se ajo nuk ka bërë kërkesë pasurore juridike në këto procedura.

III. Prova te administruara

1. Gjate seancave te gjykimit deshmitar vijues kane dhene deshmin e tyre:

a) **A.Sh** me 1 Shkurt 2011 (rigjykim) dhe me 17 Qershor 2009

b) **S.Gj** me 1 Shkurt 2011 (rigjykim) dhe me 3 Korrik 2009

c) **R.C** me 1 Shkurt 2011 (rigjykim)

d) **T.Z** me 18 Janar 2011 (rigjykim) dhe me 8 Qershor 2009

e) **M.M** me 18 Janar 2011 (rigjykim) dhe me 8 Qershor 2009

2. Avokatja mbrojtse Myrvete Qollaku ka terhequr kerkesen per te degjuar deshmitarir **J.M** (shihni procesevrbalin te seances paraprake te mbajtur me 6 Dhjetor 2010, f.4)

3. Prokurori ka terhequr kerkesen per degjimin e **A.T** (shihni procesverbalin te seances paraprake te mabjturme 6 Dhjetor 2010, f.4).

4. I pandehuri eshte degjuar me 15 Mars 2011 (shenimet personale ne faqe 4 te procesverbalit te dates 18 Janar 2011).

5. Gjykata e ka pranuar si deshmi dokumentet vijuese dhe deklaratat e deshmitarve vijues te cilat jane lexuar me ze apo jane konisderuar si te lexuara gjate shqyrtimit kryesor ne baze te nenint 368 para 3 te KPPK-se.

- i. Prova P1 – flete posedimi nga viti 2003 lidhur me parcelen 7153/10
- ii. Prova P2 – Shkresa nga Habitatit nga data 4 Prill 2006
- iii. Prova P3 – Shkresa nga Habitatit i dates 12 Qershor 2006
- iv. Prova P4 – Shkresa nga Habitatit i dates 15 Qershor 2006
- v. Prova P5 – Urdheri i debimit i dates 6 Mars 2006.
- vi. Prova P6 – Shkresa e dates 26 Prill 2006.
- vii. Prova P7 – Shenimet e policit M
- viii. Prova P8 – shenimet e tatimit te shtepise per periudh kohore 2002-07
- ix. Prova P9 – para kontrata e nenshkruar nga i pandehuri.
- x. Prova P10 – Shkresa e Habitatit e dates 6 Qershor 2006
- xi. Prova P11 – Lista poseduese e dates 19 Tetor 1999
- xii. Prova P12 – Procesverbali i seances degjimore te dates 27 Shtator 2007
- xiii. Prova P13 – Certifikata e zyres kadastrale e 3 Prillit 2006 e cekur ne procesverbal me 17 Qershor 2009.
- xiv. Prova P14 – Protokol i dorezimit te qelsit, i cekur ne procesverbal me 17 Qershor 2009.
- xv. Prova P15 – deklarata e S.C e dhene me 29 Qershor 2009 gjate gjykimit te pare (faqe 12, procesverbali i dates 1 Shkurt 2011)
- xvi. Deklarata e deshmitarit V.T deklarata e procesverbalit te dates 17 Qershor 2009 nga faqja 12 deri 20.

6. Propozimi per te degjuar D, V.T dhe N.T ne cilesin e deshmitarit eshte refuzuar me arsyetim te perfeshire ne procesverbal te dates 1 Shkurt 2011 f.15-16. Prokurori nuk ia ka siguruar gjyakes tezat e qarta te parashtrases se tij. Parashtresa e prokuroit publuik mund te kishte zgjatur proceduren dhe duke pasur parasysh akuzen e cekur ne aktakuze (neni 166 i KPPK-se) marrja e provave te till ajane te panevojshme, posaqerisht kur deshmitar

te propozuar nukishin ne vend ngjarje ne ate kohe (arg. ex art. 152 §3 subpara 1 nad 4). Ne Vazhdim palet jane pajtuar qe te lexohen deklaratat e me hershme te [A.T.] Duhet te ceket se palet nuk e kane pare te nevojshme te degjohet [D.] dhe [A.T.] gjate gjykimt te pare ne instancen e pare.

7. Provat te cilat kane ndikuar ne gjetjet e gjykates jane analizuar ne menyre eksplicite ne paragrafet vijuese. Prova te tjera nuk kishin ndikim ne permbajtjen finale te dispozitivit.

IV. Gjetjet faktike dhe ligjore

IV.A. Gjendja faktike

1. I pandehuri pas debimit ne baze te kerkeses me shkrim nga pronari [A.T.] me 4 prill 2006 nga Njësia Zbatuese e Prizren, ne rrugen " Jusuf Gervalla" (ish" Bulevardi i Skenderbegut") nr 67 në Prizren, disa ditë më vonë, [R.K.] ka okupuar lokalet e [A.T.] në mes të 4 Prillit dhe 15 Qershor 2006, dmth eshte bere ri-hyrja e paligjshme pas debimit te pare.

Sigurisht i pandehuri në fund me sukses ishte dëbuar nga objektet të cilat ai deshtoi ti leshoje pas hyrjes se tij aty. Personi i autorizuar i cili kërkoi që ai të largohet nga HPD-ja ishte oficeri ndërkombëtar [T.Z]. I pandehuri pohoi se ai pushoi nga okupimi i pronës, më 4 prill 2006 dhe se ai nuk banonë ose te kete kthyer në / për lokalet në datat në pyetje. Nuk kishte asnjë mosmarrëveshje ndërmjet palëve që objektet, subjekt i këtyre procedurave ka qenë, në çdo kohë substanciale, pronë e [A.T.] . Habitati dhe punonjësit e tyre [T.Z] dhe [M.D] ishin "personat te autorizuar" në kuptim të nenit 166 (1) të KPK-së. HPD-ja ishte përgjegjëse për zbatimin e një urdheri te dëbimit të datës 6 Mars 2006. Nuk kishte asnjë mosmarrëveshje që ky urdher të kishte te bënte me lokalet në fjalë.

2. [Z.] më 4 Prill 2006 mori pjesë në ambientet e objektit, me qëllim për të zbatuar largimit të banuesit te atehershem. Ky ishte dëbimi i dytë nga objektet. Vulat të vëna nga HPD-ja në dyert e hyrjes se objekteve, pas dëbimit të mëparshëm ishte hequr apo dëmtuar dhe drynat e dereve ishin ndryshuar. [Z.] e takoi të pandehurin jashtë derës hyrese në kuadër të lokaleve. Objektet ishin " pjesërishte

zbradura" në kuptimin që i pandehuri kishte hequr nga shtëpia të gjithë artikujt që i takonin atij. I pandehuri ishte kooperativ dhe nuk e kundërshtoi rimbylljen e dyerve të hyrjes.

3. Më 26 Prill 2006 vëllai i te pandehurit *N.K*, familja e tij dhe të familja e te pandehurit u gjetën në zaptimin e lokaleve dhe janë dëbuar.

4. Më 28 Prill 2006 *V* dhe *N.T* shkuan në zyrat e HPD-së në Prizren për të marrur çelësat e objekteve. Kur ata iu afruan derës i pandehuri e hapi derën dhe u tha atyre që të hyjne. I pandehuri ishte duke qëndruar në oborrin e objekteve.

5. Më 29 Prill 2006 Znj *T* raportuar në polici faktin e të pandehurit të vazhdueshëm rreth okupimit. Znj *T* deklaruar se dera e parë e pjesës së brendshme të objekteve ishte e hapur dhe vëllai i të pandehurit ishte ulur në shkalle që te dergojne në derën e përparme. *V.T* i tha të pandehurit për ta lëshuar pronën. Ajo e informoi atë se ajo donte të mbyll shtëpinë dhe të kthehen atje për të jetuar. Ai ofroi për të blerë objektet.

6. Më 6 Qershor 2006 *M.D*, një tjetër punonjës i HPD-së, pas së cilës mori pjesë në lokalet ai e takoi të pandehurin. I pandehuri ka deklaruar se ai kishte arritur një marrëveshje me pronarët e lokaleve.

7. Më 12 Qershor 2006 *Z* përsëri shkoi në ambientet për të zbatuar një dëbim të tretë. Bravat të cilat ishin ndryshuar më 4 prill 2006 ishte thyer dhe vulat ishin të dëmtuara ose të shkatërruar. Ekipi i HPD-së zbuloi se disa artikuj që kishin qenë të pranishëm në pjesën e brendshme të lokaleve para venies se shenjave në objekte nga rasti i mëparshëm ishin hequr. Disa sende të ndryshme janë lënë në bodrumin e një pjesë e brendshme të lokaleve. Lokalet afariste kishte qenë të ri okupuara. Pandehuri u takua me zyrtarët e HPD-së në shkallët brenda objektit. I pandehuri ishte agresive dhe kërcënuese. Pandehuri verbalisht e abuzoi ekipin e dëbimit dhe me bëri një gjest për nxjerrur armën e tij.

8. Më 15 qershor 2006 *Z* përsëri mori pjesë në shikimin e objekteve. Pas mbërritjes së tij ai zbuloi se vulat nuk ishin prishur. Lokalet ishin të ri-vulosur. Lokalet ishin të paokupuara në atë kohë. Me atë rast u shfaq pandehuri përsëri, këtë herë me vëllain e tij. I pandehuri bëri kërcënime verbale ndaj ekipit të dëbimit dhe e nxorri armën e tij.

9. Nuk kishte asnjë mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat gjatë periudhës Prill - Qershor 2006 ka pasur negociata në mes të pandehurit dhe familjes *T* për blerjen e objektit në fjale nga i pandehuri. Megjithatë, këto negociatat kanë ngecur para çdo marrëveshje që mund të arrihej. Në asnjë fazë gjatë këtyre negociatave familja *T* nuk ia ka dhene leje të pandehurit për të qëndruar në ambientet e objektit e as nuk pranoi në heshtje banimin e tij aty.

IV. B. Analizat individuale te provave

1. Termi "objektet" duhet të konsiderohet në përputhje me kuptimin e saj ligjore sipas nenit 166 § 1 te KPK-se. Objektet që kanë qenë subjekt i modifikimit te propozimi akuzës P 950/07 përbën dy parcelave të tokës të regjistruar në Zyrën Kadastrale e Kuvendit Komunal të Prizrenit në bazë të numrave 7153/10 dhe 7153/13, përkatësisht, në pronësi të regjistruar numrin 10592. Si dëshmi është një ekstrakt datë 2003-06-09 të Listës se posedimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Të dhënat ne liste tregojne që . A.C.T

ka qenë, që nga data e tij, pronari i regjistruar i ngastrës 7153/10. Objektet në fjalë janë të vendosura në rrugë Jusuf Gervalla, numri 67. Kur Prokuroria hapi çështjen e saj ajo theksoi se objektet vetëm subjekt i këtyre procedurave penale përbëhet nga parcela 7153/10. Ato lokale ishin, në çdo kohë materiale, pronë e . A.T

2. Parcela 7153/10 ishte subjekt i një urdheri per dëbim e lëshuar nga Komisioni per banese dhe kërkesa pronësore të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejshëm HPD-ja"). Drejtorati per Banesa dhe prona si dhe komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (HPD dhe HPCC) janë themeluar nga Kombet e Bashkuara Misioni i Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK), rregulloret, si një masë e përkohshme për të rivendosur të drejtat e pronësisë, zgjidhjen e kërkesave të gjatë dhe mbajtjen në këmbë sundimin e ligjit. Me Rregullat dhe Rregulloren procedurale te miratuara nga UNMIK-u më 13 Tetor 2000, Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore iu është dhënë mandati për të gjykuar rastet të cilat janë paraqitur në të.

3. Dëshmitari T.Z ka qenë i punësuar më parë si një Udhëheqës i Ekipit të Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore te Drejtorisë Çështje Pronësore dhe Banesore. Ai ishte përgjegjës për zbatimin e urdherit te dëbim. Z është aktualisht i punësuar nga Agjencia Kosovare e Pronës.

4. Dëshmitari T.Z ka deklaruar se zyra e tij ishte përgjegjës për zbatimin e urdherit te debimit me numër W/2006/3779/HPCC te datës 6 Mars 2006 në kërkesat me numer DS600714 dhe DS600719. Ai dëshmoi këtë urdher, ndër të tjera, lokalet pronë e

A.T Objektet te përbërë nga lokalet banesore dhe komerciale.

5. Z konfirmoi se më 4 Prill 2006 ai mori pjesë në ambientet për të kryer dëbimin e okupesit. Te pandehurit jashtë deres se përparme te objektit. Në lidhje me ambientet e banimit, ai përshkroi disa mosmarrëveshje procedurale në lidhje me atë që i përkiste pronës

palës së dëmtuar dhe çfarë pronës përkiste të pandehurit. I pandehuri i identifikoi ato sende që nuk i përkasin palës së dëmtuar dhe ato sende ishin larguar. I pandehuri pohoi se kishte hequr nga shtëpia të gjithë artikujt që i takonte atij. Megjithatë, disa artikuj mbeten dhe kjo ishte e paqartë nëse, në fakt, ato sende i përkiste palës së dëmtuar. I pandehuri ishte bashkëpunues dhe nuk e kundërshton rimbyllja e dyerve të hyrjes.

6. Më 12 Qershor 2006, [redacted] përsëri shkoi në lokalet në mënyrë që të zbatojë një dëbim të tretë. Ai theksoi se ky dëbim ishte rezultat i informacionit të marrë nga [redacted]. [redacted] se i pandehuri e kishte ri-pushtuar lokalet. Pas mbërritjes së tij ai vuri re se bravat te cilat ata kishin ndryshuar më 4 Prill 2006 ishin thyer dhe vulat ishin dëmtuar ose shkatërruar. Ekipi i HPD-së zbuloi se disa artikuj që kishin qenë të pranishëm në pjesën e brendshme të lokaleve para vendosjes se shenjave ne lokalet në vizitën e tyre të fundit ishin hequr. Disa sende të ndryshme janë lënë në bodrumin e një pjesë e brendshme të lokaleve. Lokalet afariste ishin ri okupuar. I pandehuri kundërshtoi me forcë veprimin e Habitatit. Në Memorandumin e tij të datës 12 Qershor 2006,

dëshmitari Z tha se i pandehuri fizikisht protestoi ri-dëbimin, duke sharë ekipin e EU-s dhe u përprek të nxjerr armën. Ai e vërtetoi këtë version gjatë shqyrtimit gjyqësor. Duke u ndërlidhur me objektet e banimit, Zt. Z dëshmoi se, ndonëse dera për në podrum ishte e hapur dhe ai i pa gjësendet e ndryshme. Pjesa banuese e objektit dukej e pashfrytëzuar dhe e ruajtur në gjendjen si ishte lënë. Mirëpo, më vonë në dëshminë e tij ai përshkroi gjësendet më të mëdha që mungonin si televizorë dhe frigoriferët. Pjesa afariste e objektit ishte shfrytëzuar përsëri.

7. Më 15.06.2006 Zt. Z përsëri e vizitoi objektin. Sapo arriti zbuloi se drynat nuk janë prekur. Objekti është vulosur përsëri. Në atë kohë objekti nuk shfrytëzohej. Në shkresën e tij të datës 15.06.2006 Zt. Z tha se gjatë vizitës së tyre i pandehuri u paraqit me vëllanë e tij. I pandehuri u kërcënua me fjalë ekipit të dëbimit, duke e nxjerr armën e tij.

8. Zt. Z ishte pyetur nga ana e prokurorisë rreth shkresës së datës 26.04.2006 e cila ishte shkruar nga ana e kolegut të tij M. D. Zt. Z vërtetoi se kanë gjetur se vëllai i të pandehurit N. K dhe familja e tij ishin duke shfrytëzuar objektin. Ata janë dëbuar dhe prona e tyre është larguar.

9. Në shkresën e datës 26.04.2006 shkruante se i pandehuri u mundua të argumentoj dhe ta bind njësinë e dëbimit se ata ishin duke bërë pazarllëk për të blerë pronën me paditësin nëpërmjet agjencive por shpjegimet e tij ishin refuzuar. Zt. Z dëshmoi se ai kishte diskutuar këtë çështje me Zt. D. Gjatë asaj vizite HPD-s nuk i është treguar asnjë kontratë, kontratë paraprake ose, çfarëdo dokumenti që do dëshmonte një pazarllëk të tillë ose marrëveshje përmes së cilës i pandehuri ishte i lejuar nga pronari të vazhdoj me shfrytëzim.

10. Në dëshminë e tij Zt. Z tha se ai kurrë nuk kishte takuar asnjë anëtar të familjes së T e as që kishte folur me ta në telefon. Ai gjithashtu vërtetoi se kurrë nuk ishte takuar me të pandehurin me përjashtim derisa ishte i pranishëm në objekt. 11. Gjykata gjeti se Zt. Z, ishte dëshmitar i ndershëm dhe i besueshëm dhe plotësisht e pranoi dëshminë e tij. 12. Shkresa e HPD-s e cila është lënë si provë nga prokuroria më 6.06.2006 i referohet diskutimit në objekt midis Zt. D dhe "të paditurit". Kur referohen "të paditurit" është qartë se i referohen të pandehurit. Në shkresën e datës 26.04.2006 Zt.

D i referohet N. K si "vëllai i

të paditurit". Gjatë bisedës i pandehuri tha se kishte arritur një "marrëveshje" me palën e dëmtuar. Njësia e dëbimit e thirri paditësin dhe ai vërtetoi por kërkoi që dëbimi të përmbrohet pa nxjerr jashtë gjësendet e të paditurit nga shtëpia përfshirë ato nga objekti.

13. Gjykata administroi si provë një kontratë të përpiluar për bartjen e ngastrës 7153/10 të nënshkruar vetëm nga ana e të pandehurit dhe faturën për tatim në pronë për vitet 2002, 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2007, nr. 2594387. Gjykata sqaroi si në vijim: emri i të pandehurit shihet në faturë. Prona së cilës i është adresuar fatura është rruga "Jusuf Gervalla" nr. 67. Në fakt, pronë së cilës i është adresuar fatura përfshinë ngastrat 7153/10 dhe 7153/13. Kontrata për bartjen e ngastrës 7153/10 të datës 12.11.2008 i referohet rrugës Bulevardi Skenderbeu nr. 67. Nuk u kontestua se Bulevardi Skenderbeu nr. 67 dhe Jusuf Gervalla nr. 68 është i njëjti objekt.

14.. Përmes shkresës së datës 28.05.2009 gjykata pranoi nga Drejtoria për kadastër dhe gjeodezi në Prizren fotokopjet e aktvendimit të datës 2.10.2008 dhe kontratën mbi shitblerjen e patundshmërisë të datës 12.11.2008. Këto dokumente vërtetojnë bartjen ligjore të asaj ngastre me numër 7153/10, që përfshinë objektin që është lënda e kësaj procedure tek M. L. (K.). Znj. T vërtetoi se objekti që ishte pronë e burrit të saj të ndjerë përbëhej nga një shtëpi dhe dy objekte afariste. Ajo dëshmoi se i pandehuri ishte vetëm në shfrytëzim të asaj prone e cila më parë ishte pronë e A.T

15. V.T ishte një dëshmitare e ndershme dhe e besueshme. Gjykata e shkallës së dytë nuk pati ndonjë ngurrim mbi dëgjimin e këtij dëshmitari gjatë gjykimit të parë. Gjatë gjykimit të parë V.T dëshmoi se palët u pajtuan të lexojnë deklaratën e saj gjatë gjykimit të dytë. V.T është vejusha e A.T dhe pala e dëmtuar. A.T vdiq më 28.05.2008. V.T vërtetoi se kërkesa e saj për pronë ishte realizuar dhe se, nën këto rrethana, ajo nuk kishte bërë kërkesë për pronë në këtë procedurë.

16. V.T dëshmoi se më 28.04.2006 ajo dhe N.T shkuan në zyre të HPD në Prizren për të marrë çelësat e objektit. Përkitazi me pronën e A.T ajo dëshmoi se kur iu afruan derës i pandehuri e hapi derën dhe i tha të hynin brenda. Znj. T dëshmoi se

i pandehuri qëndronte “në oborr” të objektit. Në dëshminë e saj të dhënë më 27.09.2007, në lidhje me takimin e datës 28.04.2006, V.T. tha se ajo kishte folur me të pandehurin për shtëpinë dhe se biseda ishte për atë që ai të lironte shtëpinë dhe mos të jetonte më aty. Ajo i tha të pandehurit mos të vjen më në shtëpi, meqenëse donte ta mbyllte dhe më pas vet të kthehej aty.

17. Më 29.04.2006 Znj. T. raportoi policisë për faktin se i pandehuri po vazhdon me shfrytëzim Znj. T. tha se dera e përparme e pjesës shtëpiake të objektit ishte e hapur dhe vëllai i të pandehurit, i cili ishte i ulur në shkallë që qonin tek dera e përparme, tha se ajo duhet të gëzohet që ata u pajtuan të flasin me të. V.T. i tha të pandehurit të largohej nga objekti. Ai si duket ofroi të blen objektin.

18. Në deklaratën e saj për policinë më 29.04.2006 Znj. T. thotë se ata do të bënin pazarllëk por se, në ndërkohë, ai duhet të largohet. Ajo i tha se kur të përfundon shitblerja ai do ti merrte çelësat. Kur ajo dëshmoi në muajin shtator të vitit 2007 V.T. tha se, gjatë takimit të tyre më 28.04.2006, i pandehuri i tha se nuk ka ku tjetër të shkon dhe nëse nuk është brenda shtëpisë ai do ta ngre shatorren në oborr. Pastaj tha se nëse djali i saj nuk vjen të bisedojnë do të bëhet një “Shtime e dytë”. Znj. T. e kuptoi se ai i referohej fshatit me atë emër ku të kthyerit serb ishin vrarë. Në dëshminë e saj Znj. T. tha se D.T. pranoi këtë kërkesë dhe e lejoi të pandehurin të qëndron në objekt për 10 – 15 ditë. Ajo tha se kjo ishte për “arsye humanitare”.

19. V.T. dëshmoi më 27.09.2007 se me datën 28.04.2006 dera e objektit nuk ishte e mbyllur dhe i pandehuri kishte qasje objektit. Të nesërmen ajo u kthye në objekt. Dera nuk ishte e mbyllur. Ajo e pa një kanape dhe e përshkroi shtëpinë si të “shkatërruar”. V.T. tha se i pandehuri i ofroi 80,000 Euro për objektin. Ajo nuk ishte në dijeni për ofertën prej 300,000 Eurove. Në dëshminë e saj V.T. përmendi pazarllëqe tjera për shitjen e objektit dhe faktin se agjenti, R.D. ishte duke kërkuar blerës të tjerë. Ajo tha se blerës të tjerë janë larguar nga i pandehuri i cili tha se ai tashmë e kishte blerë objektin. V.T. dëshmoi se ajo nuk ishte e pranishme kur D.T. bisedoi në telefon me A-S.

20. Dëshmitari në radhë, oficeri *M. M* është në shërbim të Shërbimit të Policisë së Kosovës që 9 vjet. Oficeri *M* shkroi një Raport më 15.06.2006 pas vizitës së tij në objekt. Në dëshminë e tij Oficeri *M* tha se në ditën në fjalë ai ishte i pranishëm në objekt. Roli i tij ishte të mbështet zyrtarët e HPD të cilët ndërmerrnin dëbimin e shfrytëzuesit të kundërligjshëm. Ai dëshmoi se i pandehuri dhe dy ose tre njerëz të tjerë erdhën pas ca kohe. Oficeri *M* dëshmoi se ai u takua me të pandehurin te shkallët e objektit ku i pandehuri mbeti në bisedë me oficerin për rreth 10 – 15 minuta. Oficeri *M* e përshkroi të pandehurin si “nervoz”. Sipas deklaratës së dëshmitarit aty nuk kishte asnjë sulm fizik. I pandehuri nuk e pengoj njësinë e dëbimit. Mirëpo së fundi i pandehuri e nxori armën dhe e drejtoj lartë, rreth 3-4 sekonda duke e drejtuar në ajër dhe duke thënë se nëse ky problem nuk zgjidhet në mënyrë të duhur, është e mundur që dikush të bartë pasojat. Më pas ai e futi përsëri nën rrobat e tij të zeza.

22. Deklarata e oficerit *M* nuk ka pasur pasojë të drejtpërdrejt të gjeturave faktike lidhur me atë nëse i pandehuri kishte pushtuar objektin e *A.T* duke hyrë në të kundërligjshëm ndonëse jep një prapavije të rëndësishme qëndrimit të pandehurit. Dëshmitari e përshkroi sjelljen e të pandehurit në vend. Dëshmitari fliste serbisht dhe e pranoi se nuk ishte në gjendje të përcjell tërë bisedën.

23. Dëshmitari në radhë ishte *A.S* i cili ishte pronari i Intel Service-it, agjenci e patundshmërive në Prizren. Zt. *S* dëshmoi se i pandehuri kishte ardhur në Intel Service lidhur me blerjen e objektit që është lënda e kësaj procedure penale. Në emër të pandehurit, Intel service e udhëzoi ndërmjetësuesin, *E.D* të kontaktoj me familjen e *T*. Mbrojtja e la si provë certifikatën e datës 3.04.2006 të nënshkruar nga Zt. *S* që vërtetonte ato udhëzime dhe shumën e çmimit blerës. Certifikata i referohet ngastrës 7153/9. Zt. *S* shpjegoi se si duket ndodhej një mospajtim midis ngastrave me rezultatin se i referohej ngastrës së gabuar. Nuk u kontestua midis palëve se ngastrat lëndë e certifikatës ishin 7153/10 dhe 7153/13. Zt. *S* vërtetoi se ai ishte i pranishëm në zyre të HPD më 4.04.2006 kur i pandehuri i dorëzoi çelësat e objektit HPD-s. Intel Service përpiloi kontratën paraprake të datës 29.04.2006 e cila ishte e nënshkruar nga i pandehuri. Pazarllëku dështoi kur nuk mundën të arrijnë

një marrëveshje lidhur me çmimin. Zt. S4 rikujton një bisedë me D.T. Ai nuk mund ta rikujtonte datën e saktë por mendonte se ishte përafërsisht 10 ditë para se të përpilohej kontrata paraprake. Biseda zgjati rreth 20 – 30 minuta. Zt. S4 dëshmoi se ishte e qartë nga biseda e tyre se D.T. e dinte se i pandehuri e kishte pushtuar objektin. Zt. S4 dëshmoi se e tërë ideja e bisedës ishte se personi i cili e kishte pushtuar pronën ishte blerës potencial. Në asnjë fazë të bisedës së D.T. nuk i referoj gjendjes së të pandehurit lidhur me pushtimin e tij. Nuk kishte asnjë bisedë lidhur me mundësinë e marrjes me qira të objektit të pandehurit nga familja e T. Biseda e tyre kishte të bëjë me çmimin e kontratës, afatet për përfundimin e kontratës dhe bartjen e mjeteve. Ishte e qartë se asnjë marrëveshje nuk u arrit sa i përket çmimit blerës dhe bartjen e mjeteve si rezultat i së cilës, pas disa javësh, pazarllëku dështoi. Nuk ka pasur asnjë bisedë lidhur me atë se një leje e qartë i është dhënë të pandehurit për të qëndruar në objekt e as, si duket, ndonjë shenjë se familja e T është pajtuar që i pandehuri të mbetet në shfrytëzim. Dëshmitari raportoi rrethanat dhe atmosferën e përgjithshme lidhur me procesin e pazarllëkut. Mirëpo është me rëndësi të theksohet deklarata e dëshmitarit se personi i cili e ka pushtuar pronën është blerës potencial. Kjo do të thotë se dëshmitari ishte në dijeni për pushtimin e objektit të palës së dëmtuar nga ana e të pandehurit i cili ishte në fakt i kundërligjshëm.

24. Dëshmitari i radhës ishte Dr. S67. Ai e dha deklaratën gjatë ri-gjykimit, ai qëndroi pranë deklaratave të tija të dhëna të mëparshme. Dëshmitari tha se ata të gjithë e dinin se R.K. ka jetuar në shtëpi për ca kohë dhe gjithashtu ka jetuar edhe në shtëpinë e dëshmitarit sepse ai ishte dëbuar nga tjetra me dhunë. Deklarata nënkupton se ky dëshmitar e pranon se i pandehuri ishte duke e okupuar objektin e palës së dëmtuar në atë kohë. Dëshmitari deklaroi gjatë shqyrtimit gjyqësor me datën 1.02.2011 se nuk mund të rikujtonte përmbajtjen e deklaratave të tij të mëhershme prandaj Kryetari i trupit gjykues lexoi deklaratat e mëhershme të G7. Ballkoni i shtëpisë së dëshmitarit shikonte kah oborri i objektit në fjalë. Objektet në fjalë kanë pasur kalimin e përbashkët. Ai tha se ishte e pamundshme që dikush të hyn ose të shkoj nga objekti i fqinjit të tij pa ditur ai. Dr. G7 dëshmoi për një takim të rastësishëm që ka pasur me N.T. Duke i referuar N.T. Dr. G7 dëshmoi se ajo shkoi diku të

merr çelësat dhe ishte në rrugë për në shtëpi dhe më pas ai dëshmoi se ata thanë se kanë shkuar në HPD që ti marrin çelësat. Ai nuk mund të rikujtonte datën e saktë por nga dëshmia e tij ishte e qartë se ai i referohej 28.04.2006. Dr. GJ dëshmoi se gjatë bisedës së tyre N.T kërkoj një takim me të pandehurin. N.T i referohej "çështjeve" të caktuara lidhur me objektin. Dr. GJ u pajtua të jetë ndërmjetësues dhe të rregulloj takimin. Takimi midis N.T dhe të pandehurit u mbajt disa orë pas takimit të tyre të parë. V.T ishte gjithashtu e pranishme. Kontakti i parë midis palëve ishte në oborr të Dr. GJ Dr. GJ ishte i pranishëm gjatë tërë kohës. Ai e përshkroi takimin si miqësor në fillim. Ai nuk mund të kujtonte nëse dikush u përpoq ta hapte derën e oborrit të objektit në fjalë. Dr. GJ dëshmoi se porta e hyrjes për në objekt ishte e mbyllur nga HPD. Ai dëshmoi se porta ishte e mbyllur por nuk mund të ishte i sigurt se drynat dhe vulat e HPD ishin të paprekur në kohë e takimit. Dr. GJ përmendi dy "skena të pakëndshme" kur HPD ishte i pranishëm në shtëpinë e familjes së T për të vënë në fuqi dëbimin. Incidenti i parë i këtillë ndodhi para takimit me N.T he V.T derisa i dyti ndodhi pas takimit të tyre. Ai nuk ishte i pranishëm gjatë asnjë dëbimi. Ai e rikujtoj të jetë referuar pranisë së një punëtori bullgar të HPD-s. Nuk ka dyshim se Dr. GJ ishte duke dëshmuar për periudhën e muajit prill – qershor 2006. Dr. GJ dëshmoi se ai nuk e di pse N.T dhe V.T vendosën mos të hyjnë në oborrin e shtëpisë së tyre ndonëse e kanë pasur çelësin e objektit. Ai e përshkroi atmosferë midis palëve të përkeqësuar. Ai nuk mund të shpjegonte pse. Ai përpqej të fajësoj V.T për disa fjalë nxitëse lidhur me pronësinë e objektit. Dr. GJ dëshmoi se i pandehuri dhe D.T ishin në pazarllëk lidhur me blerjen e objektit të fundit. Ishte e qartë se ato biseda kishin ca kohë që shkonin sepse përmendeshin jo vetëm çmimi i blerjes por edhe mënyra a pagesës. Ai i referohej disa bisedave telefonike midis atij dhe D.T dhe N.T Ai është pyetur për dëmin në dryna dhe vula të vënë në dyert e hyrjes nga ana e HPD-s. Dr. GJ dëshmoi se dyert dhe dritaret e shtëpisë së T ishin të hapura. Ai tha se "vjedhësit" hynë në shtëpi dhe i vodhën gjërat por ai nuk e ka parë atë. Mirëpo, ai nuk mund të thoshte çka ishte vjedhur. Në fakt, ai dëshmoi se ai fare as nuk ka

hyrë në shtëpi për të parë se çka, nëse diçka, është marr e as madje nuk raportoi çështjen policisë.

25. Në deklaratën e tij të mëparshme Dr. Gj kategorikisht kontestoi pretendimet se i pandehuri e kishte pushtuar shtëpinë e T se i pandehuri e kishte hapur derën ose se ishte në oborr. Ai vërtetoi se vëllai i të pandehurit ishte i pranishëm por në oborrin e tij dhe jo në oborrin e familjes së T. Kjo ishte në kundërshtim me dëshminë e V.T. Mirëpo, shkresa e datës 26.04.2006 i referohet vëllait të pandehurit, familjes së tij dhe familjes së pandehurit të cilët e kishin pushtuar pronën në atë ditë. Ata ishin dëbuar. Meqenëse dëbimi kishte ndodhur vetë dy ditë para takimit midis M.T dhe të pandehurit është për tu habitur që Dr. Gj nuk i referua vëllait të pandehurit i cili rishtas e kishte pushtuar ose faktin se dëbimit të tij. Në të vërtetë, kur gjykata e pyeti nëse mund të rikujton nëse vëllai i të paditurit jetonte në objekt në vitin 2006 Dr. Gj u përgjigj "Jo". Kjo ishte për tu habitur meqenëse Dr. Gj kishte dëshmuar se pronat e tyre e kanë pasur kalimin e përbashkët dhe se ballkoni i tij shikonte kah oborri i objektit. Duke u ndërlidhur me takimin me M.T, avokati mbrojtës e pyeti Dr. Gj prej nga vinte i pandehuri. Dr. Gj i në përgjigje dëshmoi se ata jetonin një kohë të gjatë në katin e parë të shtëpisë së tij dhe kjo kishte zgjatur për tre muaj. Ata rrinin në shtëpinë e tij që prej se ishin dëbuar nga shtëpia ku jetonin.

26. Duke u ndërlidhur me objektin, gjykata e pyeti Dr. Gj nëse i pandehuri ishte në fakt duke jetuar në atë kohë aty. Dr. Gj u përgjigj se nuk ishte. Dr. Gj dëshmoi se i pandehuri ishte duke jetuar në shtëpinë e tij në atë kohë. Dr. Gj lëshmoi se i pandehuri dhe familja e tij jetonin në shtëpinë e tij për përafërsisht tre muaj që prej se ishin dëbuar nga shtëpia ku jetonin. Kjo ishte një periudhë e përshtatshme për veprën me të cilën ngarkohet i pandehuri. Kjo deklaratë qartazi ishte në kundërshtim me dëshminë e dhënë nga dëshmitarët e tjerë. Gjykata e gjeti dëshminë e Dr. Gj si të pakuptueshme, si rezultat – jo të besueshme dhe qartazi e sajuar për të ndihmuar të pandehurin.

27. Palët u pajtuan që të lexojnë deklaratën e S.C. Znj. C jeton në rrugën i nr. J. Ajo dëshmoi se i pandehuri jetonte në numër në rrugën Suzi Celebi nr. 68 gjatë periudhës prill – qershor 2006. Ajo mendonte se i pandehuri dhe familja e tij erdhën në fillim të muajit prill. Ajo e përshkroi familjen e të pandehurit se ishin grua

dhe dy djemtë. Ajo tha se arsyeja pse mban ndër mend datat është se shtëpia e saj rinovohej në atë kohë. Ajo rikujton se i pandehuri punonte në Pristinë. Ajo tha se e shihte të pandehurin "shumë shpesh, jo për çdo ditë". Edhe po ta pranonte gjykata dëshminë e S.C. se i pandehuri jetonte në rrugën Suzi Celebi nr. 68 gjatë periudhës së muajit prill – qershor 2006 kjo nuk e përkrah pohimin e të pandehurit se ai edhe nuk e kishte pushtuar ose ishte kthyer në objekt që është lënda e kësaj procedure penale. E as që e dobëson dëshminë e prokurorisë të dhënë nga T.Z. Ajo tha se arsyeja pse mban ndër mend datat është se shtëpia e saj rinovohej në atë kohë. Edhe po ta pranonte gjykata dëshminë e S.C. se i pandehuri jetonte në rrugën Suzi Celebi nr. 68 gjatë periudhës së muajit prill – qershor 2006 kjo nuk e përkrah pohimin e të pandehurit se ai edhe nuk e kishte pushtuar ose ishte kthyer në objektin në fjalë. E as që e dobëson dëshminë e prokurorisë të dhënë nga T.Z. Në të vërtetë, është e mundshme të 'pushtohen' dy ose më shumë prona në të njëjtën kohë. I pandehuri është ngarkuar me hyrje në objektin në fjalë në mënyrë të kundërligjshme. Natyrisht, të qenit në shfrytëzim është dëshmi që e përkrah veprën esenciale.

28. R.C. jeton në rrugën Suzi Celebi nr. 69, Prizren. Ai gjithashtu tha se më 1.02.2011 R.K. ka jetuar në atë adresë gjatë tërë muajit prill, maj dhe qershor. Sipas dëshmitarit familja e të pandehurit dhe ai vetë ishin shumë të qetë derisa janë larguar nga aty.

29. I pandehuri dëshmoi dhe e dha versionin e tij të ngjarjeve. I pandehuri deklaroi se ai nuk e shfrytëzoi më pronën prej datës 4.04.2006 dhe se ai nuk ka jetuar dhe as që është kthyer në objekt në datat në fjalë. Ndoshta dëshmia më imponuese është vetëpohimi i të pandehurit në deklaratën e dhënë policisë më 28.06.2006 se ai ishte dëbuar dy herë nga HPD dhe më pas kishte hyrë përsëri në objekt nën përgjegjësinë e vet (shih faqen 2 në deklaratën e tij të bërë më 28.06.2006). Gjithashtu, ai pranon se ka vazhduar të jetoj në objekt. Duke thënë se ai pohon se e bëri me qëllim dhe me plotë vetëdije për pasojat e mundshme.

30. Ai tha se i ka kthyer çelësat HPD më 4.04.2006. Ai dëshmoi se nuk ka hyrë në pronë pas 4.04.2006. Qartazi kjo nuk ishte e vërtetë. I pandehuri tha se atij i është ndarë prona në vitin 1999 ndonëse ky nuk ishte një vendim i lëshuar nga administrata e UNMIK-ut. Në atë kohë prona ishte e braktisur dhe

ishite e zbrazët. I pandehuri e la si dëshmi procesverbalin e zyrës së gjeodezisë dhe kadastrës në Komunën e Prizrenit me numër 01-466-144/2 të datës 7.09.1999. Përkitazi me shkresën e HPD-s, i pandehuri tha se ata ishin duke "gënjyer". Ai përshkroi një konspiracion nga ana e HPD për të shpronësuar personat të cilët, si pohoi, kishin të drejtë me ligj të pushtojnë pronat nën rrethana të tilla si kjo. Duke u ndërlidhur me shkresa të ndryshme të HPD-s të lënë si dëshmi i pandehuri dëshmoi se dokumentet ishin "të fabrikuar". Ai e përshkroi zyrtarët e HPD-s se kanë "interes të keq". Shkresa e HPD-s e datës 26.04.2006 përmend vëllanë e të pandehurit dhe familjen e të pandehurit se janë duke shfrytëzuar që nga ajo datë. I pandehuri dëshmoi se ai nuk e dinte se kush e shfrytëzonte atë ditë. Ai dëshmoi se prej datës 24 prill e deri më 15 qershor ai dhe familja e tij kanë jetuar në rrugën Suzi Celebi. Ai dëshmoi se vëllai i tij dhe familja e vëllait të tij gjithashtu kanë jetuar në rrugën Suzi Celebi. Nuk diskutohet se vëllai i të pandehurit **N.K**

dhe familja e tij gjithashtu kanë jetuar aty. Dëshmia e të pandehurit përkitazi me këtë është thjeshtë i paqëndrueshëm. Në vet dëshminë e tij i pandehuri është i qartë kur, më 28.06.2006, tha se ishte "ende" duke jetuar në objekt me anëtarët e tij të familjes. Gjatë intervistës i pandehuri mohoj se i ka dëmtuar vultat e vendosura në dyert hyrëse nga HPD-ja. I pandehuri tha se ai ishte dëbuar dy herë dhe se *ka hyrë në shtëpi njëherë dhe u kthye përsëri*. Pyetjet e parashtruara të pandehurit gjatë intervistës ishin të qarta dhe të sakta dhe përgjigjet që ai dha ishin të qarta.

31. Sipas mendimit të gjykatës përfundimi plotësisht i bazuar është se mbrojtja të cilën e ndjek **R.K** është a paqartë, jo koherent dhe përmbante kundërshtime të brendshme. Provat e administruara dhe përshkrimi i hollësishëm i të gjitha fakteve dhe rrethanave e sjellin gjykatën deri përfundimin se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet në aktakuzë.

IV.C. Gjendja mendore e kryerësit.

1.I pandehuri e dinte se prona ishte nën urdhrin për dëbim. I pandehuri, vetë, ishte dëbuar nga objekti. Në të vërtetë, ai ishte i pranishëm në katër rastet ndërmjet 4 prillit dhe 15 qershorit 2006 kur HPD e vuri në zbatim urdhrin. Ai

nuk ka pasur autorizim ligjor ose arsyetim për të hyrë në objekt pas datës 4.04.2006. Për këtë shkak, i pandehuri veproi në mënyrë të kundërligjshme kur më pas hyri në banim ose në objekt të mbyllur. Sipas mendimit të zinxhirit të rrethanave faktike drejton drejtpërdrejt te R. K. si kryerës. Askush tjetër nuk ishte i interesuar të hyjë ilegalisht në objektin e palës së dëmtuar. Fakti se i pandehuri ishte i interesuar të blenë pronën e kontestuar është gjithashtu jashtë çdo argumenti. Në procesverbalin e datës 28.06.2006 edhe ai vetë tha se ishte dëbuar dy herë dhe kishte hyrë përsëri në objektin e kontestuar me vendimin e vetë. S.G. nuk ka vërejtur asnjë të huaj që sillej përreth në lagje dhe as që raportoi vjedhje ose plaçkitje përderisa është dashur të sheh diçka, sidomos se ai si pretendon e ka pasur të pandehurin në shtëpinë e vetë. Dëshmitarët, sidomos T. Z dhe M. M vërtetuan praninë e të pandehurit gjatë dëbimeve prej 4 prillit e deri më 15.06.2006. Madje i pandehuri vërtetoi praninë e tij ndonëse kishte disa dallime të vogla (nxjerrja e armës) me sjelljen e tij në vend. Gjatë gjykimit nuk ka pasur dyshime se pas dëbimit me datën 4.04.2006 vëllai i të pandehurit ishte parë i pranishëm në objektin afarist. Ai veproi me qëllim të kryerjes së veprës me të cilën ngarkohej.

2. I pandehuri u deklarua i pafajshëm për veprën me të cilën ngarkohej. Mirëpo versioni i të pandehurit nuk bazohet në dëshmitë e administruara. Duhet të theksohet (tashmë për të tretën herë në këtë arsyetim) se i pandehuri vetë tha në procesverbalin e datës 28.06.2006 se ai ishte dëbuar dy herë dhe kishte hyrë përsëri në objektin e kontestuar me vendimin e vetë. Pasojat ligjore natyrale të vendimit të tij është aktgjykimi i tanishëm. Sipas mendimit të gjykatës nuk ka asnjë dyshim për gjykatën se i pandehuri e ka kryer veprën cenimi i paprekshmërisë së banesave nga neni 166 (1) i Kodit penal të Kosovës. Pasi është dëbuar i pandehuri ka hyrë përsëri në objektin e palës së dëmtuar. Gjithashtu, sipas mendimit të gjykatës, do të ishte paska vështirë të bazohet në mënyrë të arsyeshme dhe të besueshme praninë e të pandehurit gjatë dëbimeve kur nuk ishte i ftuar. Duke pasur ndër mend tërë rrjedhën procedurale faktike prania e tij nuk mund të trajtohet vetëm thjeshtë si rastësi. Motivi më i mundshëm i veprimeve të tija ishte të mbetet posedues i objektit duke llogaritur në disa ndryshime të sistemit ose në dorëzime shtetërore me qëllim që të bëhet bile pronar i ligjshëm *per facta concludentia*.

IV.D. E drejta e zbatueshme materiale.

1. Krimi i cenimit të paprekshmërisë së banesave nga neni 166 (1) i Kodit penal të Kosovës në datën e kryer është cilësuar nga dispozitat e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës. Gjatë dënimit gjykata e zbatoi ligjin që është tani në fuqi i cili në fakt nuk ndërron shumë nga Kodi i përkohshëm penal. Nuk ka asnjë ndryshim në përmbajtje esenciale të saj. Pas dëbimit të mbajtur më 4.04.2006 i pandehuri hyri përsëri në objekt. Pasojat natyrale *de facto* të veprimeve të pandehurit ishte se objekti nuk ishte i braktisur efektivisht sipas përmbajtjes së urdhrorit për dëbim që zbatohet nga HPD. Neni 166 (1) i KPK nuk kërkon një provë të drejtpërdrejt se i pandehuri vetë i theu vulat dhe drynat. Gjykata duhet të çmon se i pandehuri veproi në mënyrë të kundërligjshme kur hyri në banesë ose në objekt të mbyllur të personit tjetër ose nuk u largua nga objekti me kërkesën e personit të autorizuar. Në lëndën e tanishme gjykata çmon se *Q.K* hyri përsëri në objektin e mbyllur. Akti i lartpërmendur ndodhi pas dëbimit me datën 4.04.2006. Personi i autorizuar i cili e kërkoi dëbimin ishte *V.T* dhe personi i autorizuar që e zbatoi dëbimin ishte *T. Z* i cili ishte duke vepruar në emër të palës së dëmtuar (paditësit në lëndën civile të përmarimit). Gjykata e caktoi gjendjen e fakteve sipas dëshmiave që kishte në dorë dhe sipas ligjit.

2. Në aktin penal të cenimit të paprekshmërisë së banesave, sipas nenit 166 (1) të KPK, finalizohet pas hyrjes së kundërligjshme në banesë ose objekte të mbyllura. I pandehuri i ka ndërmar të gjitha kushtet ligjore dhe kërkesat e parapara me ligj sipas nenit 166 (1) të KPK-s. Zgjedhja alternative e paraparë me dispozitat e lartpërmendura (mos largimi nga objektet e tilla) rëndom është pasojë natyrale e aktit e cila ndodhi në fillim. Nuk përbënë një parakusht të domosdoshëm në këtë rast.

IV.E. Rrethanat personale e të pandehurit.

1. *Jeta e mëhershme e kundërvajtësit.* Përkitazi me këtë rrethanë, para kryerjes së veprës penale i pandehuri e kishte thyer ligjin.

2. *Qëndrimi i kundërvajtësit gjatë kryerjes së veprës penale.* Sjellja e kundërvajtësit si i akuzuar në rrjedhën e tërë procedurës penale ishte kryesisht korrekt. Kundërvajtësi gjatë gjykimit ishte kundërshtues por gjykata e trajtoj si mënyra e sjelljes e së drejtës së tij për tu mbrojtur. Këto dy argumente e formojnë rrethanat lehtësuese të cilat janë marr parasysh gjatë matjes së dënimit.

IV.F. Matja e dënimit.

1. Dënimi me burgim matet sipas përmbajtjes së nen.64 të KPK kushteve të lartpërmendura dhe sipas qëllimit të përmendur në nenin 34 të KPK, sidomos parandalimi i kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimi i kryerësit, është caktuar me periudhë prej gjashtë (6) muajve si më e përshtatshme, proporcionale dhe e saktë.
2. *Shkalla e përgjegjësisë penale.* Intensiteti i veprës së kundërvajtësit nuk ishte në nivel që kërkon një sanksion më të ashpër se sa burgimi prej gjashtë muajve Shkalla e përgjegjësisë penale është mesatare.
3. *Motivet me të cilat është kryer akti.* Sipas mendimit të gjykatës motivi më i mundshëm i veprimeve të tija ishte të mbetet posedues i objektit duke llogaritur në disa ndryshime në sistem ose në dorëzime shtetërore me qëllim që të bëhet bile pronar i ligjshëm i pronës *per facta concludentia*. Sipas asaj më lartë motivet si të tilla ishin përfitimi pasuror i cili duhet të vlerësohet si bazë.
4. *Intensiteti i rrezikut penal ose lëndimi i vlerës së mbrojtur.* Ndikimi negativ i kësaj vepre në stabilitetin e marrëdhënieve të qarkullimeve pronësore dhe pozita e palës së dëmtuar (si përfaqësues i pakicës etnike) mund të bënë që gjykata të arrin në një përfundim për shkallën e rrezikut të shkaktuar nga një akt i këtillë, sidomos nga pikëvështrimi i vlerës së mbrojtur, është kryesisht e lartë. Asnjë palë nuk do të duhej të përfitoj nga pozita më e dobët e palës tjetër, sidomos në qarkullimin e patundshmërive dhe duke pasur ndërmend garantimet ligjore për pakicat etnike të parapara me ligjet e brendshme si dhe me ligjet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.
5. Gjykata çmon se dënimi me burgim prej gjashtë muajve është i barasvlershëm me peshën e veprës, duke marr parasysh karakterin

e mëparshëm të mirë e të pandehurit dhe veprën e kryer. Dimensionin tjetër i këtij aktgjykimi është të udhëzon shoqërinë se ky lloj i sjelljes nuk tolerohet dhe se merr reaksionin e duhur të Drejtësisë. Gjithashtu duhet qartë të theksohet se mungesa e jurisprudencës lidhur me nen.166 të KPK-s ose prania e saj e mundshme nuk mund të fitoj mbi gramatikën e leksikut të KPK-s. Dispozita qartë shënon se gjykata lejohet të caktoj dënimin deri në 3 vjet dhe asnjë jurisprudencë nuk mund ta ndryshoj kornizën ligjore të dënimit.

IV.G. Elementet e mbetura të aktgjykimit.


Gjykata e përfshiu kohën e kaluar në burgim nga dënimi i mëparshëm i shkallës së parë i cili ishte anuluar me aktgjykimin e Gjykatës supreme Pkl-Kzz 103/09 të datës 22.04.2010

Për shkak të arsyeve këtu të përmendura e marr këtë aktgjykim.

Me datën 18.03.2010

.....
Gjyqtari Witold Jakimko

.....
Procesmbajtësi Tarik Mripa



Punëtorja e Prizrenit
Gjykatësi
Tarik Mripa

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi të marr nga shkalla e parë është e lejuar ankesa në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes të së njëjtës, drejtuar Gjykatës së qarkut në Prizren përmes Gjykatës komunale në Prizren.